



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (f) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), në harmoni me Ligjin Nr. 02/L-70 për sigurinë në komunikacionin rrugor, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, Ligji nr. 04/L-179 për transportin rrugor, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.06/L-070 për Transportin rrugor, Ligji Nr. 2003/11 mbi rrugët, Ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120, Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.06/L-068, Ligji Nr. 04/L-076 për policinë, Ligji Nr. 2012/04-L-174 për planifikimin hapësinor, Ligji Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në bazë të Nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2023, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR APROVIMIN E PLANIT TË TRANSPORTIT RRUGOR 2023-2027 PËR KOMUNËN E DEÇANIT

#### Neni 1

Aprovohet Plani i Transportit Rrugor 2023-2027, për Komunën e Deçanit.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Plani i Transportit Rrugor 2023-2027, për Komunën e Deçanit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike e komunës së Deçanit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Arhivit.

01.Nr.XI-3

Deçan.dt.29.12.2023

### KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:  
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (k) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), **në bazë të :** Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-176.

Ligji Nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 Për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247.

Ligji Nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.

Ligji për ndërtim, Nr. Nr. 04/L-110.

Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Nr. 06/L-024.

Ligji për Inspektoratin e produkteve të ndërtimit, Nr. 02/L-62.

Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

Si dhe në bazë të Nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2023, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR APROVIMIN E PROGRAMIT KOMUNAL PËR BANIM SOCIAL 2023-2026

#### Neni 1

Aprovohet Programi Komunal për Banim Social 2023-2026, për Komunën e Deçanit.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Programi Komunal për Banim Social 2023-2026, për Komunën e Deçanit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e komunës së Deçanit.

#### Neni 4


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Arhivit.

01.Nr.XI-4

Deçan,dt.29.12.2023

### KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:  
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në bazë të nenit 37 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera Nr.04/L-027("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.22/2011), Neni 12, neni 15 dhe neni 31 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, neni 26 pika 7. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2023, miratoi këtë:

## V E N D I M

MBI APROVIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA TË GJITHA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

### Neni 1

Me këtë vendim aprovet Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të gjitha fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit, gjatë vitit 2023.

### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të gjitha fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit, gjatë vitit 2023, i dt.19.12.2023, me Nr. të protokollit 02-42080.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e kryetarit të Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për BPZHR e Komunës së Deçanit.

### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: MAPL, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë për BPZHR, Zyrës për Informim dhe Arkivit të Komunës.

01.Nr.XI-5  
Deçan,dt.29.12.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	DEÇAN - DEÇANI - DEÇANE REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY
Nr. i Protokollit: <u>KK Deçani AS 788</u>	
Data: <u>01</u> / <u>05.01.24</u>	
No. i regjistrit: _____	
DEÇAN DEÇANE	

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ



*[Signature]*





Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (c) dhe nenin 17 shkronja (f) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), në bazë të nenit 15 dhe nenit 34 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.17 / 29 Qershor 2012 ) , Ndryshohet/Plotësohet nga Ligji Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 29 / 1 Shtator 2022 ), si dhe në bazë të Nenit 26 pika 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2023, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR APROVIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR KOMUNËN E DEÇANIT

#### Neni 1

Aprovohet Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Deçanit.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave, për Komunën e Deçanit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike e komunës së Deçanit.

#### Neni 4


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Arhivit.

01.Nr.XI-6

Deçan,dt.29.12.2023

### KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:  
Hajdar SUTAJ





Bazuar në nenet 11 dhe 12, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenin 13 shkronja c), Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në Rregulloren (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Statutit të Komunës Nr. 01/38717, të datës 07.11.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.12.2023 miraton këtë:

## V E N D I M

### PËR APROVIMIN E RREGULLORES PËR PËRZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT TË DALLUAR PËR KOMUNËN E DEÇANIT

#### Neni 1

Aprovohet Rregullorja për përzgjedhjen e mësimitdhënës të dalluar për Komunën e Deçanit.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Rregullorja për përzgjedhjen e mësimitdhënës të dalluar, për Komunën e Deçanit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e komunës së Deçanit.

#### Neni 4


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Arsim dhe Arhivit.

01.Nr.XI-7

Deçan,dt.29.12.2023

### KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:  
Hajdar SUTAJ





Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, në bazë të nenit 3 paragrafët 1.4, 1.12 dhe 1.13, nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 dhe nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 14 dhe nenit 19 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, Prill 2019), në bazë të nenit 13 dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2023, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR MIRATIMIN E VENDIMIT PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

I.

MIRATOHET Vendimi përfundimtar për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092.

II.

Prona e paluajtshme e komunës së jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë Nr.00429-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 23036 m<sup>2</sup>, me kulturë Mal i klasës 4, Zona kadastrale Deçan, në pronësi të Komunës së Deçanit.

III.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II. të këtij vendimi është për zhvillimin e veprimtarive ekonomike afariste, që nuk cenojnë rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin dhe që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

IV.

Afati kohorë i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, i përshkruar në pikën nr.II. të këtij vendimi, është afatgjatë, në periudhën kohore për 99 vite.

V.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfituesit të ofertës së përzgjedhur ose përfaqësuesit të autorizuar të tij.

VI.

Prona Komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II. Të këtij vendimi, duhet të evidentohet në Librat kadastrale të Komunës së Deçanit.

VII.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë kompetente të Komunës së Deçanit.


VIII.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Raporti i Komisionit vlerësues për ofertën e përzgjedhur, Certifikata e njësisë kadastrale, skica grafike.

IX.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.XI-13  
Deçan, dt.29.12.2024



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ